V E N D I M
Nr.7, datë 26.4.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Hilmi Dakli,	Anëtari	“““
Manol Konomi,	Anëtari	“““
Franc Jakova,	Anëtari	“““
Zija Vuci,	Anëtar i““	
Alfred Karamuço,	Anëtari	“““
Veli Budo,	Anëtari	“““

me sekretare Drita Filto, në datën 28.2.1996, 6.3.1996, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr. 7 Akti, që u përket :

KËrkuesve:1.KOMITETI KOMBETAR I ORGANIZATES SE VETERANEVE TE LUFTES ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE, i përfaqësuar nga zv/kryetari, Adnan Qatipi dhe anëtari i kryesisë, Sul Domi.

2. KESHILLI I PERGJITHSHEM I ORGANIZATES SE BASHKUAR TE VETERANEVE TE LUFTES, i përfaqësuar nga Islam Blushi.

SUBJEKT I INTERESUAR : KESHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.

O B J E K T I:

Rishikimin e Vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.245, datë 22.05.1995 dhe nr.581, datë 25.10.1995, pasi vinë në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për Statusin e Veteranit të Luftës kundër Pushtuesve Nazifashistë të Popullit Shqiptar”.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V E R E N :

Në paragrafin e fundit të nenit 8 të Ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për Statusin e Veteranit të Luftës kundër Pushtuesve Nazifashistë të Popullit Shqiptar”, është parashikuar se masa e shpërblimit të veteranëve do të ndryshohet në varësi nga indeksi i çmimeve dhe inflacionit. Kërkuesit kanë parashtruar që të detyrohet Këshilli i Ministrave të zbatojë dispozitën e mësipërme.

Gjatë shqyrtimit të çështjes Gjykata ka konstatuar se pas daljes së Vendimit nr.190, datë 03.05.1995 që ka caktuar masën e shpërblimit të veteranëve, janë bërë

rritje të pagave të personave që janë në marrëdhënie pune me shtetin si dhe të pensioneve, përkatësisht me Vendimet nr.581, 582 e 587; datë 25.10.1995 të Këshillit të Ministrave.

Nga sqarimi i dhënë nga Këshilli i Ministrave me shkresën nr.1961, datë 09.04.1996 si dhe nga shpjegimet e specialistëve të Ministrisë së Financave dhe të

Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, ka dalë se në rritjen e pagave dhe pensioneve, midis të tjerave është marrë parasysh në një masë të caktuar edhe indeksi i çmimeve dhe inflacionit.

Gjykata konstaton se deri më sot nuk ka dalë ndonjë Vendim i Këshillit të Ministrave për të vënë në zbatim paragrafin e fundit të nenit 8 të Ligjit “Mbi Statusin e Veteranit të Luftës”, lidhur me indeksimin e shpërblimit, edhe pse dispozita ligjore ka hyrë në fuqi që në 1 Dhjetor 1994.

Në këto kushte është detyrë ligjore e Këshillit të Ministrave që sa herë indekson pagat e

pensionet për efekt rritje çmimesh e inflacioni, të indeksojë, shpërblimin e veteranëve, në zbatim të nenit 8, paragrafi i fundit të Ligjit nr.7874, datë 17.11.1994.

PER KETO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 24 të Ligjit Nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin Nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me unanimitet,

V E N D O S I :

Detyrimin e Këshillit të Ministrave të zbatojë kërkesat e nenit 8 paragrafi i fundit të Ligjit Nr.7874, datë 17.11.1994 "Për Statusin e Veteranit të Luftës kundër Pushtuesve Nazifashistë të Popullit Shqiptar", lidhur me indeksimin e shpërblimit siç është zbatuar për pagat dhe pensionet.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot në Tiranë, më 26.04.1996